



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Municipal of Istog

K O M U N A E I S T O G U T
S H P A L L
A N K A N D P U B L I K
Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim

Duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës si dhe Vendimit të Kuvendit Komunal 01 Nr.28/2018 të datës 29.03.2018 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, Komuna e Istogut:

Shpall
Ankand Publik

Ftohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë që janë të interesuar për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës e cila gjendet në Zonën Kadastrale në Cerrcë që të aplikojnë në ankandin publik duke respektuar procedurën si më poshtë:

Lokacioni i pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim

- Jepet në shfrytëzim njësia kadastrale nr.00028-92, në zonën kadastrale në Cerrcë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5830 m², e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si Pronë Shoqërore- shfrytëzues e mirë e fshatit, Cerrcë.
- Sipërfaqja e ofruar në ankand jepet për qëllim të zhvillimit ekonomik.

Çmimi fillestar i pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim përmes ankandit publik

- Çmimi fillestar për dhënien e tokës publike në shfrytëzim për metër katror do të jetë 0,05 Euro (pesë centë) për një (1) vit.
- Përzgjedhja e fituesit bëhet në bazë të çmimit më të lartë të ofertuar në ankand publik.

Afati i dhënies në shfrytëzim

- Afati kohor për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës së paluajtshme është pesëmbëdhjetë (15) vite.

Veprimtaria që do të ushtrohet

- Prona e dhënë përmes ankandit publik mund të shfrytëzohet për përdorimin e gurit gëlqeror dhe prodhimin e rërës për ndërtim.

Afati i fundit për aplikim

- Ofertat mund të dorëzohen në afatin prej 30 ditëve duke filluar nga data e publikimit të ankandit publik. Afati i fundit për dorëzimin e ofertës do të jetë deri më 21.06.2018 deri në ora 13:30.

Data, koha dhe vendi i hapjes së ofertave

- Hapja e ofertave do të bëhet nga Komisioni Komunal për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale në prezencë të ofertuesve, më 21.06.2018 në ora 14.⁰⁰, në sallën e takimeve nr. 311, kati i tretë.

Forma në të cilën do të mbahet ankandi publik

- Ankandi publik do të mbahet përmes ofertave të mbyllura.

Numrat kontaktues, emaili, adresat për informacion shtesë:

- Personi kontaktues, Faton Bujupi, tel. zyrtar 049/766-714, email: faton.bujupi@rks-gov.net, kontakti nga ora 08.00-16.00.

Tërheqja e aplikacionit për të ofertuar në ankandin publik

- Formulari për të konkurruar në ankand mund të merret në formë fizike në zyrën numër 310 dhe atë elektronike në web faqe të Komunës www.rks.gov.net/istog

Personat të cilët aplikojnë në ankand publik për marrjen e pronës në shfrytëzim duhet të prezantojnë këto dokumente shtesë:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit (duke përfshirë numrin fiskal)
- Certifikatën e TVSH-së
- Vërtetimin e tatimit në pronë
- Dëshmitë mbi kryerjen e obligimeve ndaj komunës së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të ofertës
- Planet e biznesit
- Kopjen e letërnjoftimit.

Informatat shtesë dhe vizitat për shikimin e lokacionit mund të bëhen gjatë gjithë periudhës së ankandit publik (30 ditë) duke iu referuar zyrës së Drejtoratit për Urbanizim, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Ofertat e mbyllura dhe të protokolluara duhet të dorëzohen në afatin e lartcekur në zyrën Nr.100, për shërbim të qytetarëve.

Oferta duhet të jetë në origjinal me 2 kopje shtesë.

Të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga ky ankand publik përcaktohen me kontratë ndërmjet Komunës dhe fituesit të ankandit publik.

Komuna e Istogut.

Më 22.05.2018